 <p>DA Drejtoria e Akreditimit</p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	Vizita vlerësuese	Kodi DA-PT-002
		Rishikim nr 0 Dt ____/____/____
		Faqe 1 nga 7

Vizita Vlerësuese

Zbatues: Kryevlerësuesi, vlerësuesit, ekspertët dhe stafi teknik i DA

Përgjegjës për zbatimin: Menaxheri i cilësisë

	Hartoi	Kontrolloi	Miratoi	Data e miratimit
Botimi I	Ardita Fuga	Ardita Fuga Besnik Pani	Agim Anxhaku	
Rishikimi 01				

 <p>Drejtoria e Akreditimit</p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	Vizita vlerësuese	Kodi DA-PT-002
		Rishikim nr 0 Dt ____/____/____
		Faqe 2 nga 7

1. QËLLIMI

Qëllimi i kësaj procedurë është të përcaktojë rregulla të qarta dhe sa më efektive për vlerësimin në vend të organizmave të vlerësimit të konformitetit. Vlerësimi në vend është pjesë e procedurës së akreditimit për të vlerësuar kompetencën teknike të organizmave të vlerësimit të konformitetit.

2. FUSHA E ZBATIMIT

Kjo procedurë zbatohet gjatë kryerjes së vlerësimit në vend të kompetencës së organizmave të vlerësimit të konformitetit. Procedura zbatohet në procesin e akreditimit, zgjerimit, reduktimit, mbikqyrjes dhe rivlerësimit. Të njëjtat rregulla të vendosura në këtë procedurë zbatohen edhe gjatë vizitave të paravlerësimit.

3. PËRGJEGJËSITË

Procedura zbatohet nga vlerësuesit, kryevlerësuesit, ekspertët dhe stafi teknik i DA. Për kontrollin e zbatimit të kësaj procedure përgjegjësi ka menaxheri i cilësisë.

4. REFERIMET

Standardi S SH ISO/IEC 17011:2003 “Kërkesa të përgjithshme për organizmat e akreditimit të cilat kryejnë akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit”, paragrafi 7.7.

Manuali i cilësisë DA-MC-001


5. FJALORI DHE SHKURTIME

Për qëllimet e këtij dokumenti janë përdorur termat dhe përkufizimet e dhëna në standardin S SH ISO/IEC 17011 dhe në manualin e cilësisë.

6. PROCEDURA

6.1 Të përgjithshme

Vlerësimi është një hap i rëndësishëm i procedurës së akreditimit të organizmave të vlerësimit të konformitetit për të vlerësuar nëse plotësohen kërkesat e standardeve dhe kërkesa të tjera të specifikuar nga Drejtoria e Akreditimit. Vizita

 <p>DA Drejtoria e Akreditimit</p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	Vizita vlerësuese	<i>Kodi DA-PT-002</i>
		<i>Rishikim nr 0</i> Dt ____/____/____
		<i>Faqe 3 nga 7</i>

vlerësuese kryhet nga grupi i vlerësimit. Ajo zhvillohet në të gjitha ambientet e organizmit të vlerësimit të konformitetit nëse fusha që do të vlerësohet zhvillohet në disa ambiente.

6.2 Caktimi i datës së vlerësimit

Grupi i vlerësimit në bashkëpunim me specialistin e DA propozojnë datën e organizimit të vizitës vlerësuese në vend. Kjo datë i njofthet organizmit të vlerësimit të konformitetit sipas formës DA-FO-005. Organizmi duhet të japë miratimin e tij brenda datës së shënuar në formën DA-FO-005. Nëse organizmi nuk përgjigjet brenda kësaj date, ky propozim quhet i miratuar. Nëse organizmi nuk është dakort me datën e propozuar ai ka të drejtë ta refuzojë dhe të propozojë një datë tjetër. Përshtatshmëria e kësaj date vlerësohet nga grupi i vlerësimit dhe në rast të kundërt i propozohet organizmit një datë tjetër.

6.3 Dërgimi i planit të vlerësimit

Grupi i vlerësimit përgatit planin e vlerësimit. Specialisti i DA i dërgon organizmit që do të vlerësohet planin e propozuar sipas formës DA-FO-002. Organizmi që do të vlerësohet ka të drejtë ta miratojë ose jo planin e propozuar. Cdo ndryshim në plan miratohet nga të dyja palët. Në planin e vlerësimit përfshihen edhe testimet/kalibrimet e dëshmisë si dhe caktohen certifikimet dhe inspektimet ku grupi i vlerësimit do të marrë pjesë.


6.4 Kryerja e vizitës në vend

Fazat nëpër të cilat kalon vizita vlerësuese janë:

- mbledhja paraprake e grupit të vlerësimit
- hapja e vizitës vlerësuese
- vizita në organizëm
- vlerësimi i sistemit dhe vlerësimi teknik
- konsultimet e grupit të vlerësimit
- mbledhja e grupit të vlerësimit për përgatitjen e mbledhjes finale
- mbledhja mbyllëse

6.4.1 Mbledhja paraprake

Mbledhja paraprake, kryhet për të diskutuar detajet e vizitës vlerësuese dhe për të shpërndarë detyrat midis anëtarëve të grupit të vlerësimit. Ajo drejtohet nga

 <p>DA Drejtoria e Akreditimit</p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	Vizita vlerësuese	<i>Kodi DA-PT-002</i>
		<i>Rishikim nr 0</i> Dt ____/____/____
		<i>Faqe 4 nga 7</i>

kryevlerësuesi. Gjatë kësaj mbledhjeje rifreskohen detyrat që ka cdo vlerësues dhe nëse ka dalë ndonje gjë e re.

6.4.2 Hapja e vizites vleresuese

Hapja e vizitës kryhet nga kryevlerësuesi i cili

- a) prezanton grupin dhe detyrat e secilit
- b) shpjegon qëllimin e vizitës
- c) ilustron planin e vizitës dhe sqaron gjithë pikat që nuk janë përfshirë
- d) paraqet ndarjet e mundshme të grupeve, fazat e vizitës dhe optimizon kohën.
- e) bën modifikimin e mundshëm të planit të vizitës
- f) ilustron procedurën e vlerësimit dhe mundësinë e organizmit për të prezantuar dyshimet e tij.
- g) deklaron detyrat e secilit anëtar të grupit të vleresimit
- h) kërkon nje salle per mbledhjen e grupit te vleresimit
- i) kërkon pjesëmarrjen e drejtuesit te organizmit (të pakten në mbledhjen perfundimtare.
- j) Prezanton provën/kalibrimin/certifikimin/inspektimin që do të kryhet


6.4.3 Vizita në organizëm

Vizita zhvillohet për të vlerësuar zbatimin e sistemit të cilësisë së organizimit dhe për të vlerësuar kompetencën teknike. Gjatë vlerësimit, grupi i vlerësimit përdor metodën e intervistës, kontrollit të dokumentacionit, vëzhgimit dhe vlerësimit të rezultateve dhe rregjistrimeve dhe vlerësimin horizontal dhe vertikal. Vlerësimi i zbatimit të sistemit të menaxhimit kryhet nga kryevlerësuesi, ndërsa kompetenca teknike vlerësohet nga vlerësuesit teknk sipas planit të vlerësimit. Grupi i vlerësimit përdor të gjitha mjetet që ai ka në dispozicion për të vlerësuar performancën e organizmit. Vlerësuesit plotësojnë check-listat përkatëse, ((DA-FO-017, DA-FO-019, DA-FO-020, DA-FO-021, DA-FO-025, DA-FO-035) si dhe formën DA-FO-003 për cdo moskonformitet.

6.4.4 Konsultimet e grupit të vlerësimit

Vlerësuesit, kur e shohin të nevojshme, mund të realizojnë konsultime të grupit, në lidhje me:

- freskimi i planit të vizitës
- shkëmbimin e informacioneve të dobishme për vazhdimin e vizitës
- përcakton modifikimet e mundshme të planit të bazuar në faktet e reja.

 <p>Drejtoria e Akreditimit</p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	Vizita vlerësuese	Kodi DA-PT-002
		Rishikim nr 0 Dt ____/____/____
		Faqe 5 nga 7

Në rastin kur kryhen mbledhjet e ndërmjetme, kryevleresuesi duhet të ndërpre momentalisht vlerësimet, dhe në fund të mbledhjes i komunikon personit të autorizuar të organizmit modifikimet e rastit që ka sjelle kjo mbledhje në planin e vizitës

6.4.5 Mbledhja e grupit te vleresimit

Para mbledhjes përfundimtare me organizmin, vleresuesit mblidhen për të diskutuar me kryevlerësuesin mbi moskonformitetet e gjetura gjatë vizitës vlerësuese. Për cdo moskonformitet plotësohet formulari DA-FO-003 dhe hartohet një listë e moskonformiteteve të gjetura në gjithë organizmin. Në rastin e mendimeve të ndryshme nga ana e vlerësuesve për formulimin e moskonformiteteve, pas sqarimeve të laboratorit, kryevlerësuesi raporton, në një raport të vecantë, argumentat për të cilat nuk u arrit unanimiteti dhe pikëpamjet e vlerësuesve për të cilat kanë shfaqur dyshime.

6.4.6 Mbledhja mbyllëse

Ne mbledhjen mbyllëse marrin pjesë titullari i organizmit, i gjithë grupi i vlerësimit, përfaqësues të organizmit, menaxheri i cilësisë së organizmit dhe personi i caktuar nga DA (nëse kryevlerësuesi nuk është staf i brendshëm i DA)

- paraqitet një përmbledhje e vlerësimit të kryer
- paraqiten moskonformitetet e gjetura dhe vëzhgimet përfundimtare, duke sqaruar përmbajtjen e formularit përkatës i cili duhet të jetë i firmosur nga përgjegjësi i organizmit, ose person i autorizuar nga titullari i organizmit
- përmbledh dyshimet e paraqitura nga organizmi
- i le organizmit kopjen e moskonformiteteve të gjetura


Brenda 2 javësh, kryevleresuesi dorëzon raportin e vlerësimit në DA. Gjithashtu ai dorëzon të gjithë formularët e plotësuar, check-listat dhe cdo dokument tjetër i cili është marrë gjatë procedurës së vlerësimit. Vlerësimi i gjithë procedurës së akreditimit kryhet sipas procedurës DA-PT-001, DA-PT-003, DA-PT-004, DA-PT-009, DA-PT-010.

7. DIAGRAMA

Organizmi ka të drejtë të aprovojë ose jo datën e vlerësimit dhe të propozojë një datë tjetër

Plani i vizitës miratohet edhe nga organizmi që do të vlerësohet

Kryevlerësuesi organizon hapjen e vizitës vlerësuese ku shpjegohet plani i vizitës dhe qëllimi i vizitës



Kryevlerësuesi dhe vlerësuesit në bashkëpunim me specialistin e DA propozojnë datën e zhvillimit të vizitës vlerësuese sipas formës DA-FO-005

Caktohet data e vlerësimit me miratim të të dyja palëve


Grupi i vlerësimit propozon planin e vizitës vlerësuese sipas formës DA-FO-002

Grupi i vlerësimit para se të filloj vlerësimit organizon një mbledhje për të rifreskuar edhe njëherë detyrat që cdo vlerësues ka.

 <p>Drejtoria e Akreditimit</p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	<h2>Vizita vlerësuese</h2>	Kodi DA-PT-002
		Rishikim nr 0 Dt ____/____/____
		Faqe 7 nga 7

Për cdo paqartësi, ndryshim të planit apo raste të tjera që mund të paraqiten gjatë vlerësimit, vlerësuesit mund të kërkojnë konsultime me kryevlerësuesin dhe pjesën tjetër të grupit të vlerësimit. Gjatë konsultimeve kryevlerësuesi ndalon vizitën vlerësuese

Kryevlerësuesi raporton të gjitha gjetjet tek stafi i organizimit



Vlerësimi bazohet në kriteret e vendosura për akreditim

Në përfundim të vlerësimit grupi i vlerësimit organizon një mblehdje për të raportuar dhe diskutuar brenda për brenda grupit gjetjet e cdo vlerësuesi

8. RREGJISTRIME

Titulli i dokumentit	Kush e plotëson	Kur e plotëson	Kush e ruan
Forma e njoftimit të datës së vlerësimit DA-FO-005	Përgjegjësi i sektorit të akreditimit	Përpara se të kryhet vlerësimi	Përgjegjësi i sektorit të akreditimit
Forma e planit të vlerësimit DA-FO-002	Kryevlerësuesi	Përpara se të kryhet vlerësimi	Përgjegjësi i sektorit të akreditimit
Format e vlerësimit DA-FO-001, DA-FO-013 DA-FO-003	Kryevlerësuesi	Pas kryerjes së vlerësimit	Përgjegjësi i sektorit të akreditimit
Check-listat DA-FO-019, DA-FO-017 DA-FO-020, DA-FO-035 DA-FO-021 DA-FO-025	Kryevlerësuesi, vlerësuesit	Pas kryerjes së vlerësimit	Përgjegjësi i sektorit të akreditimit

